



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

**OBJEKTIVAT FORMUES DHE KARAKTERISTIKAT E PROGRAMIT  
MASTER PROFESIONAL NË INFERMIERI PEDIATRIKE**

**Profili kulturor dhe profesional i studimit në përfundim të programit mësimor**

Programi i studimit: *MP në Infermieri Pediatrike* synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e infermierisë pediatrike. Ai ka për objektiv të përgatisë infermierë pediater / neonat me formim të avancuar për të ofruar kujdes shëndetsor të kualifikuar për gjithë fëmijët që vuajnë nga patologji që nga momenti i lindjes deri në moshën e adoleshencës.

Duke përdorur një kombinim të mirë-balancuar të instruktiveve didaktike në auditor, seminareve për diskutimin e ekspëriencës klinike dhe praktikës klinike të avancuar në repartet e pediatrikës, studentët e FSHP në këtë program mësojnë si të masterizojnë dhe integrojnë praktikën e tyre klinike me trajnimin në përmirësimin e cilësisë së shërbimit, liderhipin infermior, kërkimin klinik, informatizimin infermioristik dhe politikat shëndetsore e sociale.

Kjo ekspërtizë akademike bazohet në praktikën klinike më cilësore, duke përgatitur jo vetëm infermierë specialistë që kërkohen lokalisht për momentin, por edhe liderë infermiorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, që do të udhëheqin të ardhmen e infermioristikës, duke e rritur rolin e infermierit në shërbimin shëndetsor në përgjithësi.

Ky program synon:

- Të lehtësojë zhvillimin e njohurive, aftësive për aplikim në mjediset e infermierisë pediatrike.
- Të zgjerojë njohuritë e studentëve për kërkim shkencor në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të praktikës.

Në përfundim të programit të studimeve studentët do të marrin diplomën: **Master profesional në Infermieri Pediatrike.**

**Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor.**

Në përfundim të programit mësimor studentët do të jenë të aftë:

- Të analizojnë në mënyrë kritike konceptet dhe teorinë rreth njohjes, përgjigjes dhe menaxhimit të gjëndjes shëndetsore tek pacienti në moshën pediatrike në qendrat shëndetsore.
- Të identifikojnë konceptet kyçe që lidhen me punën me fëmijët dhe familjarët e tyre, si ruajtjen e sigurisë, rritja dhe zhvillimi, teorinë e lidhjes dhe angazhimit me foshnjat, fëmijët dhe familjen.
- Të vlerësojnë faktorët socio-ekonomik, fiziologjik dhe psikologjik që ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve, të të rinjve dhe familjeve të tyre.
- Të aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në shërbimin shëndetsor ku ata do të jenë punësuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

**Mundësitë për punësim**

Në përfundim të këtij programi të ciklit të dytë të studimeve studentët do të kenë njohuri, vizion, aftësi dhe eksperiencë të mjaftueshme për të ofruar një kujdes infermieror me cilësi të lartë, bashkëkohor, të bazuar mbi gjykimin kritik të fakteve tek një spektër i gjerë pacientësh në çdo hallkë të shërbimit pediatrik:

- Reparti i Pediatriisë - Terapi Intesive / Spital Rajonal, rrethi apo Spitalet Universitare
- Reparti i Neonatologjisë – Terapi Intesive / Spital Rajonal, rrethi apo Spitalet Universitare
- Konsultorin e fëmijëve / Shërbimi shëndetësore parësor